E mërkurë, 28 shkurt 2024

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit paraqiten përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Vërej për procesverbal, që të katërt të akuzuarit na ndjekin përmes videolidhjes, pasi kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për të qenë të pranishëm në sallën e gjyqit.

Si zakonisht unë kam disa aspekte procedurale që dua të trajtoj përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit.

Së pari, z. Emmerson, ju deshët t'i thoshit diçka Trupit Gjykues sa i takon kalendarit të seancave për periudhën e verës.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po flas në emër të ekipit të z. Veseli. E pamë programin, kalendarin pra, dhe mënyra sesi është organizuar për tre javë ky kalendar dhe ju kujtohet mbase që ne patëm disa javë të vështira, që ishin tre javë të vështira, për ne një javë katër ditore është shumë e vështirë për ta bërë.

Nuk e di se na mbështesin edhe ekipet e tjera të Mbrojtjes sepse nuk e kemi diskutuar, po të jemi një çik më praktikë sa i takon përgatitjes së dëshmitarëve, se përgatitemi rast pas rasti, duhet të na jepni hapësira me nga një bllok në një bllok tjetër që të kemi mundësi që të përgatitemi për secilin nga dëshmitarët.

Në realitet, tri javë/një javë pushim, tri javë/dy javë pushim, ka funksionuar për ne deri tani. Por më shumë se kaq është problematike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua të theksoj, që nuk do jetë një model ky.

Do ta bëjmë vetëm një herë në mënyrë që të përshpejtojmë pak seancat.

E kuptoj shumë pikën tuaj. Dhe nuk po them që nuk pajtohem. Po unë dua që patjetër të kapim pak ritmin dhe mendova që do të ishte një mënyrë e mirë që ta bënim këtë përpara sa të merrnim pushimet e Gjykatës gjatë verës.

Z. EMMERSON: [Përkthim] E kuptoj unë. Po shihni këtë javë na ikën ditët kot. E kuptoj, e mirëkuptoj këtë që ka ndodhur, por po na vendosni një barrë shumë të madhe me këtë organizim të ri.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësoj këtë. E kuptoj dhe do të marrim një vendim.

Së dyti, Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja e z. Veseli ka kërkuar një regjistrim të orëve për kundërpyetjet e Mbrojtjes

dhe se duhet të bëjmë një zbërthim të pyetjeve nga ana e Mbrojtjes që burojnë nga pyetjet e Trupit Gjykues. Ne e kuptojmë këtë dhe nuk jemi kundër.

Së pari, a keni ndonjë kundërshtim për këtë lloj, që të bëjmë këtë zbërthim të kundërpyetjeve, pra, kundërpyetjeve nga ana e Mbrojtjes dhe kundërpyetjeve që burojnë nga Trupi Gjykues.

Ka parashtrime nga ana e Prokurorisë?

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mirëmëngjes. Ju e keni për çështje regjistrimi që të kuptojmë sa kohë është kuptuar për kundërpyetjet edhe sa kohë dashur për pyetjet që kanë lindur nga Trupi Gjykues?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, duam ta bëjmë një analizë në mënyrë që të mos jemi të padrejtë përkundrejt Mbrojtjes.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Nuk ju dëgjoj. Mund t'ju dëgjoj nga salla, po nuk ju dëgjoj nga mikrofoni.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më dëgjoni, të tjerët? Mikrofonin ndezur e kam.

Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund t'ju ndihmoj dhe unë kam ndonjëherë të njëjtin problem, duhet të ngrini volumin, ndonjëherë ndodh që kur hap e mbyll mikrofonin ndryshon edhe volumi i zërit.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni ende

këtë problem? Sepse duhet të njoftojmë teknikët për këtë.

Z. MISETIC: [Përkthim] Ka ditë që ndodh. Sa bëhem gati unë të them që s’punon, ajo rregullohet vetë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu na ndodh të gjithëve, herë mirë herë keq jemi.

Ne po themi që ne nuk jemi personat që mbajnë evidenca për kundërpyetjet. Ne themi që të bëjmë një zbërthim siç duhet në mënyrë që të mos të cenohet Mbrojtja. Është Zyra Administrative dhe Njësia për Administrimin e Gjykatës që e bën këtë lloj zbërthimi të orarit.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e rëndësishme për ne është të marrim shifrën në total. Parimisht, nuk ka problem për ne. Por në qoftë se pyetjet pas pyetjeve të gjykatësve janë shumë të gjata do jetë e vështirë pastaj që t’i vendosim kufi orarit që është dashur për kundërpyetjet dhe do kemi problematika për këtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj unë këtë, por i takon Trupit Gjykues të vendosë për të vendosur kufijtë dhe deri tani nuk kemi pasur asnjë rast për të marrë një vendim të tillë. Faleminderit për komentin tuaj.

Nga ekipet e Mbrojtjes ka diçka për të thënë?

Z. TULLY: [Përkthim] E mbështesim këtë. Që të t’i shohim më të zbërthyera në orar kundërpyetjet tona.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Sa i takon parashtrimit të palëve, atëherë Trupi Gjykues

miraton kërkesën e Mbrojtjes së Veselit dhe t'i kërkojë Zyrës për Administrimin e Gjykatës që kur të përllogarisë kundërpyetjet e Mbrojtjes të mos përfshijë këtu kundërpyetjet që burojnë nga pyetjet e Trupit Gjykues.

Dhe me kaq mbyll urdhrin me gojë.

E njëjta gjë vlen edhe për Prokurorinë. Nëse keni pyetje shtesë apo pyetje plotësuese, këto nuk do të përfshihen tek orari që kishit kërkuar fillimisht për pyetjet tuaja të drejtpërdrejta.

Së treti. Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja ka kërkuar në parashtrimin F02153 ka kërkuar autorizim, pra, që dëshmia 03878 të kryhet përmes videolidhjes. Pasi personi fillimisht tha që do të vinte këtu fizikisht, po më pas pati ndryshime dhe nuk mund të vinte.

Përpara se të vendosim në lidhje me këtë kërkesë Trupi Gjykues do donte që të dëgjonte parashtrime prej palëve nëse kanë kundërshtime apo kundërpërgjigje lidhur me këtë aspekt sa i takon videolidhjes.

I drejtohem fillimisht Zyrës Administrative nëse kanë diçka për të thënë.

Z. ROCHE: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar Gjykatës. Zyra Administrative është në gjendje ta realizojë kërkesën në datat që është kërkuar. Masat e përcaktuara jua kemi dërguar me postë elektronike më 23 shkurt 2024. Dhe mund t'ju them më tej që ne mund ta zbatojmë këtë. Në rast se ka nevoja për të

marrë masa të mëtutjeshme, ne do të informojmë në kohën e duhur Trupin Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Ka ndonjë gjë nga Mbrojtja?

Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

Vërej që për këtë dëshmitar që dëshmitari ka qenë këtu, të paktën nga ana e Mbrojtjes, me aq sa ka dijeni Mbrojtja, ka pasur mundësi të udhëtonte drejt Hagës. E dimë. Ama ju them që Mbrojtja nuk është njoftuar për ç'arsye u largua, as nuk jemi informuar nga Prokuroria nëse personi ka pasur ndonjë problem shëndetësor apo ndonjë aspekt tjetër pse u dashka që të bëhet me videolidhje.

Duke marrë parasysh që Mbrojtja nuk është informuar për arsyet e duhura, ne e kundërshtojmë këtë kërkesë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I dimë ne arsyet, jemi në dijeni të arsyeve dhe sa, nga pikëpamja jonë, kjo nuk cenon procesin gjyqësor. Ka qenë një çështje krejtësisht e pavarur.

Z. MISETIC: [Përkthim] E pranoj këtë. Por unë po ju them, parimisht që të mos bëhet precedent kjo të mos njoftohemi ne, sepse nuk mund të pajtohemi për diçka për të cilën s'na kanë dhënë informacion paraprakisht.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Mbështes të njëjtin qëndrim. Ky është një dallim nga praktika jonë e përgjithshme. Por për sa kohë ky nuk do të jetë një precedent, nuk kam asnjë

kundërshtim.

Z. TULLY: [Përkthim] Mbështesim të njëjtin qëndrim.

Z. BAIESU: [Përkthim] Edhe ne mbështesim të njëjtin qëndrim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do të marrim vendimin dhe do t'ju vendosim në dijeni në lidhje me të. Padyshim, që do të nxjerrim urdhër me gojë sot sepse datat e propozuara për videolidhjen janë shumë afër, janë direkt dhe janë shpejt pas pushimit që kemi, menjëherë pas pushimit që do të kemi.

Po ashtu vërej në bazë të vlerësimit psikologjik -- më falni do të kalojmë në seancë private për këtë.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të fillojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë 01140 që do dëshmojë përmes videolidhjes dhe kjo është një masë që është miratuar përmes Trupit Gjykues në parashtrimit të protokolluar F01975.

Asistente e Gjykatës, ju lutem sillmi dëshmitarin në ambientin ku ndodheni.

E thashë në gjininë femërore, po nuk jam i sigurt a është Sekretari apo Sekretarja e Gjykatës.

Z. TULLY: [Përkthim] Ndërkohë që presim dëshmitarin. E di që ju thatë që do bëjmë më shumë pushime. A mund të na thoni të paktën për arsye planifikimi kur do të jetë pushimi i radhës?

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi parashikuar një pushim në orën 10.00.

Dhe pastaj të shohim në varësi të gjendjes së dëshmitarit sa është në gjendje që të vazhdojë dëshmitari.

Z. TULLY: [Përkthim] Në rregull. E kuptoj këtë gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi, Dëshmitar. A na dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po ju

dëgjoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretari i Gjykatës do t'ju japë një tekst që është deklarata solemne të cilën duhet ta merrni në përputhje me rregullën 141(2) të rregullores. Shiheni dokumentin dhe lexojeni me zë të lartë.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në rregull.

I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetës dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W01140

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

[Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

Do të fillojmë sot me dëshminë tuaj, që mendohet se do të zgjasë vetëm përgjatë ditës së sotme.

Sikurse e dini, fillimisht jua bën pyetjet Prokuroria, pastaj Mbrojtësi i Viktimave dhe në fund edhe Mbrojtja ka të drejtën t'ju bëjë pyetje. Anëtarët e Trupit Gjykues, Gjykatësit, gjithashtu mund të kenë pyetje për ju.

Prokuroria ka parashikuar një orë për t'ju bërë pyetje. Mbrojtësi i Viktimave 15 minuta. Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar rreth 3 orë për t'ju bërë pyetje. Uroj që të gjitha palët të jenë të kujdesshme që të shfrytëzojmë sa më mirë

kohën e caktuar. Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje shtesë nëse plotësohen kushtet përkatëse.

Dëshmitar, përgjigjuni qartë dhe me fjali të shkurtra. Nëse nuk kuptoni një pyetjen, lirisht kërkoni që pyetja që përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni dhe ata do ta sqarojnë pyetjen për ju.

Gjithashtu mos harroni të na thoni ku i bazoni faktet dhe njohurinë për të cilat do t'ju bëjnë pyetje.

Në qoftë do t'ju kërkohet nga ZPS-ja të konfirmoni disa nga korrigjimet që keni bërë në deklaratat tuaja, ju lutem thoni me zë për procesverbal që deklarata me shkrim, përfshirë korrigjimet përkatëse, reflekton saktësisht dëshminë tuaj.

Gjithashtu flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë në mënyrë që t'ju ndjekin edhe përkthyesit.

Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në këtë sallë gjyqi, nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë ambientit të Gjykatës. Nëse ndonjë person ju bënë pyetje jashtë Gjykatës për dëshminë tuaj, na vini në dijeni.

Gjithashtu nëse ju them të mos flisni më, ndaloni së foluri dhe gjithashtu mos flisni më nëse e shihni që unë ngre dorën. Kjo do të thotë që mund të kem nevojë të jap një udhëzim.

Nëse keni nevojë për pushim, na thoni dhe do ta mundësojmë.

Tani dëshmia juaj do të fillojë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

Znj. Prokurore, fjala është për ju.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duhet të konfirmoj për procesverbal që Dëshmitari 01140 ka hyrë në ambientin e Gjykatës dhe ka mbështetjen nga një anëtar i stafit të ZMMD-së edhe nga unë që jam Sekretari i Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Jemi në seancë publike.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës.

Pyetje nga Znj. Clanton:

ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

PY. Dhe mirëmëngjes Dëshmitar. Unë jam Sarah Clanton. Edhe jam një nga Prokuroret e ZPS-së, unë jam Prokurorja që sot do t'ju drejtoj pyetjet.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private në mënyrë që të flasim për të dhënat personale të dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për mbrojtjen e dëshmitarit, ju lutem, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

PY. Pyetjet e radhës lidhen me deklaratat e mëparshme të

cilat keni dhënë ju.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Asnjë prej tyre nuk është për publikun.

I lutem Sekretares së Gjykatës të vendosë në ekran materialin me numër ERN 028512-0128516-ET E Rishikuar RED dhe me të njëjtin numër ERN në gjuhën origjinale.

PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit tuaj, e shihni një deklaratë dhe e njihni këtë deklaratë apo e dalloni që kjo është një deklaratë që e keni dhënë ju?

PË. Po.

PY. Shkojmë më poshtë në të majtë, e njihni nënshkrimin në fund të faqes?

PË. Po, është nënshkrimi im.

PY. Faleminderit.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës që tani të vendosë në ekran materialin 028544 deri në 028546-ER *Revised* RED me të njëjtën ERN në serbisht dhe RED në fund.

PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit e njihni këtë deklaratë?

PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Shkojmë më poshtë.

PY. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin në këtë faqe?

PË. Po, është nënshkrimi im.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem tani Sekretares së Gjykatës të vendosë në ekran materialin me numër ERN 208643-

028648-ET RED2.
PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit, e njihni deklaratën, a është kjo një deklaratë që keni dhënë ju?
PË. Po.
ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Shkojmë më poshtë.
PY. Dëshmitar, e njihni nënshkrimin në këtë faqe?
PË. Po, nënshkrimi është i imi.
ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares së Gjykatës që të vendosë në ekran materialin 069662-TR-ET Pjesa 1 RED2.
PY. Kjo është një deklaratë e vitit 2019 që keni dhënë për ZPS-në. Intervista është e zbardhur dhe nuk ka nënshkrim.
Por, Dëshmitar, a ju kujtohet që ju ka intervistuar Zyra e Prokurorit të Specializuar?
PË. Po, më kujtohet.
ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
PY. Dëshmitar, a ju kujtohet në fund të vitit të shkuar një ekip nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, mes të cilëve isha dhe unë, erdhi në vendin ku ndodheshit bashkë me një përkthyes dhe ju lexuan deklaratat që kishit dhënë më përpara?
PË. Po.
PY. A ju kujtohet që unë dhe kolegët kur ishim bashkë, ju na dhatë sqarime edhe disa korrigjime për disa nga deklaratat e mëparshme mua dhe kolegëve të mi?

PË. Po.
PY. A ju kujtohet që i shtypëm dikund këto sqarimet dhe korrigjimet dhe ua lexojë në gjuhën tuaj një përkthyes?
PË. Po.
PY. Dëshmitar, duke marrë parasysh korrigjimet dhe sqarimet që bëtë kur jemi takuar, të cilat ne ua lexuam më pas, a mund të themi tani që informacioni apo përmbajtja në deklaratat tuaja është e saktë dhe e vërtet me aq sa besoni ju?
PË. Ju lutem përsëriteni? Se unë këtë nuk e kuptova.
PY. Po. Dëshmitar, nëse marrim parasysh korrigjimet dhe sqarimet që bëtë ju kur u takuam vitin e kaluar ne, të cilat ua lexoj dikush, tani informacioni që gjendet në katër deklaratat që sapo pamë ne në ekran pak ë përpara, pra, informacioni a është i saktë dhe i vërtet me aq sa besoni dhe keni ju njohuri?
PË. I saktë është.
PY. Dëshmitar, nëse përfshijmë të gjitha korrigjimet dhe sqarimet që keni bërë kur jemi takuar rishtazi vitin e shkuar dhe të cilat ua lexuam, këto katër deklarata që pamë në ekran para një çasti, a reflektojnë saktësisht atë që do të thonit sot nëse do t’ju bënin të njëjtat pyetje për të njëjtat ngjarje?
PË. Po.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranimin e deklaratave të mëparshme dhe provave materiale

shoqëruese të dëshmitarit dhe të gjitha këto janë pjesë e vendimit sipas rregullës 154, përkatësisht 01976. Për procesverbal, ne kërkojmë që të pranohen dy versionet të përkthyera në gjuhën angleze të rishikuara të cilat zëvendësojnë ato që ishin pranuar më parë sipas vendimit të rregullës 154. Për këtë janë njoftuar palët. Dhe ERN e reja të rishikuara janë 028512 deri në 028515-ET Të Rishikuara RED dhe 028544 deri në 028746-ET Të Rishikuara që zëvendësojnë versionet e mëparshme të këtyre dokumenteve që gjendeshin në poshtëshënimin 49 të vendimit sipas rregullës 154.

Krahas kësaj, që prej kohës që kur është lëshuar ky vendim janë pranuar edhe dy prova materiale shoqëruese përkatësisht 208566 deri në 028596 është pranuar si prova materiale P01028. 028547 deri në 028556 është pranuar si prova materiale 3D00014. Kështu që ne kërkojmë që provat materiale shoqëruese që ende nuk janë pranuar të pranohen si do të pranohet Shënimi Përgatitor numër 1, që është ngarkuar në *Legal Workflow* dhe ka ERN 117797-117805.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Dokument ERN 25812 deri në 028516-ET pranohet si provë.

028544 deri në 028446-ET pranohet.

643 deri në 628648-ET RED2 pranohet.

Bashkë me Shënimin Përgatitor 1 dhe provat e tjera të lidhura me të, përveç atyre që ishin pranuar, pranohen.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Paraqesim Pjesën 1 deri në 4 të këtij dokumenti, pra, dokumentit 069662.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thatë Pjesa 1 më parë?

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Tani, 1 deri në 4. Pjesën 1 e paraqitëm thjesht si shembull.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se nuk ka kundërshtim, pjesët 1 deri në 4 të kësaj prove pranohen.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Për të korrigjuar procesverbalin, është 028643 deri në 028658 dhe jo 648.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kam shkruajtur gabim prandaj e thashë gabim. Pra, me këtë korrigjim kjo provë pranohet. Më duket thashë edhe provat e shoqëruara, përveç atyre të dyjave që ishin pranuar.

Kështu që, mund të vazhdoni, znj. Prokurore.

Mund t'ia caktoni numrat tani ose më vonë.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mund ta bëj tani.

Deklarata e parë, 028512 deri në 028516 të gjithë versionet - anglisht, shqip, serbisht - do të kenë numrin P10131.

Deklarata e dytë që ka ERN 028544 deri në 028546 në të tre gjuhët do të jetë prova materiale me numër P1032.

Deklarata e tretë me numër ERN 028643 deri në 028658-ET RED2, bashkë me versionet anglisht dhe serbisht do të kenë numrin P1033.

Deklarata e katërt me katër pjesë, me numër 099662-TR-ET, në dy gjuhët do të ketë numrin Pjesa e parë P1034.1. Pjesa e dytë do të ketë numrin P1034.2. Pjesa e Tretë do të jetë prova me numër P1034.3. Ndërsa Pjesa e Katërt do të ketë P1034.4.

Dy provat që janë për t'u pranuar, e para, që ka numrin 069663 deri në 069664 do të jetë provë me numrin P1035. Provat e shoqëruara me të 074946 deri në 074948 do të jenë provë materiale me numrin P1036.

Ju kërkoj ndjesë. Shënimi Përgatitor me numër ERN 117797 deri në 117805 do të ketë numrin P1037 si provë materiale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Kemi një përmbledhje të shkurtër publike që mund ta lexojmë.

Pra, Dëshmitari W01140 ishte banor i Prizrenit. Në qershor 1999 u rrëmbye dhe u rrah nga anëtarët e UÇK-së. U rrah shumë dhe u kërcënua me vdekje. Gjatë kësaj kohe pa dhe persona tjerë të ndaluar të lënduar.

U lirua nga një anëtar i UÇK-së të cilin e njihte që më parë. Edhe sot vazhdon të vuajë nga dëmtimet që ka pësuar aso kohe.

Tani, z. Kryetar, mund të vazhdojmë me seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private, Sekretare, për të mbrojtur dëshmitarin.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] I lutem Sekretares të paraqesë në ekran provën me numrin V000-4004-1-A_1.09.57-1.13.02. Ndërsa presim, mund t'ju them se numri ERN është V000-4004-1-A-TR-ET_1.09.57-1.13.02.

Në transkriptin që do të shohim në faqen 31.

PY. Dëshmitar, dua t'ju tregoj një video -- një minutë ju lutem.

Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, nuk kam kundërshtim t'i tregohet dëshmitarit video as patjetër për zërin. Por në qoftë se ka në audio, me një fjalë, incizim për diçka që mund të pyetet dëshmitari. Duhet që së pari të pyetet nëse ai çfarë shikon ai në këtë video dhe në qoftë se ka nevojë mund ta luajmë videon pa e dëgjuar pyetjen sepse s'dua që dëshmitarit t'i bëhen pyetje sugjestionuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta dëgjojmë pa zë dhe pa përkthim, pa përkthim dhe pastaj do të shikojmë çdo bëjmë.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Video është në gjermanisht. Ka një transkript në anglisht. Me sa di unë, dëshmitari nuk flet as gjermanisht as anglisht. Mund të luhet pa kuptuar gjë dëshmitari, me kusht që përkthyesit të mos ia përkthejnë në gjuhën e vet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e pranueshme?

Z. MISETIC: [Përkthim] Është e pranueshme në qoftë se realizohet teknikisht.

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni. Shfaqeni me zë.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

PY. Video, është një pjesë e një video, fillon pak përpara teksti dhe zëri, pra, fillon përpara se të shikonim figurën.

Pra, në fillim të këtij klipi në ekran do të ketë një pamje tjetër nga ato që do të dëgjoni. Ju lutem përqendrohuni tek ajo që paraqitet në video pasi të largohet një automjet. Këtu, për këtë jam e interesuar.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju lutem ta luajmë këtë pjesë dhe pastaj do t’ju bëj disa pyetje.

PY. Dëshmitar, jemi në seancë publike mos e ndërprisni, shikojeni një herë videon.

[Luhet videoincizimi]

ZNJ. CLANTON: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, a mundët ta shihnit videon nga vendi ku jeni?

PË. Po, po, e pashë.

PY. Dhe në këtë video pas tankut, kishte dy burra që po shkonin drejt një ndërtese. A e njohët këtë ndërtesë?

PË. Po, është seminari i Prizrenit.

PY. Në dëshminë e mëparshme P01031 thoni se ju dhe familja juaj morët masa që të largoheshit nga Prizreni. Tek ky vend shkuat, tek ndërtesa e seminarit?

PË. Po.

PY. Ajo që pamë në video është vendi ku keni fjetur?

PË. Ne fjetëm jashtë, përjashta sepse ai ishte plot e përplot. Nuk kishe vend fare. Vendi ku flinim pra.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private për pjesën tjetër të pyetjeve lidhur me këtë temë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

Dëshmitar, do të bëni një pushim prej dhjetë minutash në këtë moment. Ndihmësja e Gjykatës do t'ju shoqërojë të dilni nga vendi aty ku jeni, të largoheni.

Ndërpriteni. Nuk e ndërprisni dot?

[Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës këshillohen]

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë një pushim deri në 10.10.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.00

--- Seanca rifillon në orën 10.11

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shoqëroni dëshmitarin të hyjë në sallë. znj. Asistente e sallës kërkoni që dëshmitari të hyjë në seancë.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Dëshiroj që të konfirmoj se dëshmitari është rikthyer në sallë së bashku me zyrtaren e Mbështetjes së Dëshmitarëve të Gjykatës dhe me Sekretarin e Gjykatës. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rikthehemi në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 11.01

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të lidhemi me dëshmitarin, dua që të jap një urdhër me gojë lidhur me kërkesën e Prokurorisë me numër F02153.

Megjithëse Trupi Gjykues mendon se këto duhen marrë parasysh në rrethana të jashtëzakonshme, prania e dëshmitarit është opsioni kryesor. Nëse duhet ta lejojmë lidhjen me video, Trupi Gjykues merr parasysh shumë gjëra si shëndetin,

vendndodhjen, kohëzgjatjen, kompleksitetin e çështjes, arsyet logjistike dhe masa të tjera që duhen marrë.

Në rastin aktual, në rastin konkret, dëshmitari ka rrethana shëndetësore të cilat paraqiten në kërkesë dhe Trupi Gjykues mendon se është e nevojshme që ta bëjmë për mirëqenien e dëshmitarit.

Meqenëse Mbrojtja është në gjendje t'i bëjë pyetje dëshmitarit, nuk besoj se do të paragjykohen të akuzuarit dhe aftësia e dëshmitarit për të dëshmuar.

Mbasi kemi shqyrtuar kërkesën me kujdes e kemi marrë parasysh dhe vlerësimin e Zyrës Administrative, Trupi Gjykues është i bindur se ekzistojnë rrethanat që dëshmitari konkret të dëshmojë përmes videokonferencës. Jemi të bindur se kjo nuk do t'u shkaktojë asnjë dëm të akuzuarve dhe do të kontribuojë në kryerjen e shpejtë dhe të drejtë të procedurave.

Prandaj, e miratojmë kërkesën e Prokurorisë dhe autorizojmë dëshmitarin që të dëshmojë nëpërmjet videokonferencës në përputhje me rregullin 144.

Dhe këtu përfundon urdhrin gojor i Trupit Gjykues.

Për sa i takon sugjerimit tonë për të ndryshuar kalendarin, duke filluar në mars, dhe po e theksoj 10 maj, 24 maj, 15 qershor deri në 18 tetor, dhe nëntor 28, Trupi Gjykues do të ndjekë këtë program, këtë kalendar, duke pasur parasysh paralajmërimin e Mbrojtjes së Veselit.

I kërkoj Prokurorisë të kenë parasysh që kjo do të jetë

java e katërt në radhë dhe pastaj do të ketë një pushim të gjatë dhe sugjerojmë me shumë forcë që dëshmitarët që do të vijnë për një kohë të shkurtër, të vijnë në atë javë me qëllim që të mos zgjaten shumë dhe të mos detyrohemi t'i mbajmë dëshmitarët për një periudhë të gjatë duke pasur parasysh pushimin e verës.

Z. Halling dje përmendi bllokun tjetër të dëshmitarëve. Duam të sqarohemi se cilët janë dëshmitarët rezervë. Ai përmendi dëshmitarin që sapo, për të cilin sapo folëm, dhe sugjeroj që duhet të kemi një dëshmitar rezervë pas këtij. Do ta vlerësonim në qoftë se do të na njoftonit brenda kësaj jave.

Në rregull. Z. Ndihmës i Gjykatës, ju lutem, silleni dëshmitarin në dhomë ku do të dëshmojë.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

[Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, më dëgjoni mirë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vazhdojmë me pyetjet e Mbrojtjes së Selimit.

Z. Tully, mund është vazhdoni.

Jemi në seancë publike. Dëshironi të kalojmë në seancë private?

Z. TULLY: [Përkthim] Nuk besoj se mund t'i bëj pyetje në

seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për mbrojtjen e dëshmitarit, Sekretarja udhëzohet që të na kalojë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca ndërpritet deri në orën 14.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.05

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, silleni dëshmitarin në dhomë.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se jeni kthyer, Dëshmitar. Shpresoj të keni pasur rastin të pushoni pak.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, faleminderit shumë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vazhdojmë me pyetjet e z. Misetic. Dëgjojeni me kujdes.

Vazhdoni, z. Misetic.

Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Mirëdita përsëri, Dëshmitar. Dua që të më konfirmoni dy

gjëra.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mirëdita.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. MISETIC: [Përkthim] Në seancë private, ju lutem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private, Sekretare.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

Z. BAIESU: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, ju thatë që në rrugët e Prizrenit kishte mbizotëronte kaosi në rrugët, në vitin 1999, sepse njerëzit kremtonin fundit e luftës, kështu ka qenë?

PË. Po. Kur hyri KFOR-i ishte, mbizotëronte anarki e plotë.

PY. Gjatë seancës para pushimit thatë që njerëzit qëllonin me armë nëpër rrugët e Prizrenit, kështu ka qenë?
PË. Po. Kur unë u lirova nga paraburgimi dëgjoja të shtëna. Futeshin, kontrollonin, futeshin nëpër dyqane me forcë, e bënin gjëra të tilla. Unë fshihesha nëpër qoshet e rrugëve dhe pata fat që kisha veshur pantallona të zeza dhe në njëfarë mase ngatërrohesha me popullsinë dhe mund të flisja shqip shumë mirë dhe kështu arrita të shkoj në shtëpi. Ndryshe nuk do të kisha rritur kurrë aty.
Z. BAIESU: [Përkthim] Për procesverbal e kisha fjalën tek faqja 79, rreshtat 16-17 nga transkripti.
PY. Kishte civilë të armatosur me armë në gjithë rrugët e Prizrenit në ato ditë, kështu?
PË. Kështu ka qenë, po. Kështu ka qenë. Kishte dhe automjete nga Shqipëria që erdhën, bërtisnin, qëllonin me armë, me tesha civile kanë qenë.
PY. Dëshmitar, dua t'ju tregoj një tjetër video që është DJK00732.
Z. BAIESU: [Përkthim] I lutem Sekretares që ta shfaqë në ekran.
[Luhet videoincizimi]
Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit.
PY. Dëshmitar, kjo video, a e tregon gjithashtu situatën në Prizren në qershor të vitit '99, në mes të qershorit të vitit '99?

PË. Po.

Z. BAIESU: [Përkthim] Z. Kryetar, e ofrojmë këtë video që të pranohet në provat gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë materiali me numër DJK00372 [Sipas përkthimit].

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kësaj prove i vendoset numri 4D34.

Sa i takon klasifikimit mund të vazhdojë të jetë publike?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të jetë publike.

Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Faleminderit të nderuar Gjykatës. Unë kaq pyetje kisha.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

Mirëdita, Dëshmitar.

Për një sqarim, por do të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë çështje për të ngritur?

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Është një çështje për të cilën

kërkoj sqarim, nëse nuk ka problem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Ka lidhje me një prej urdhrave gojarisht sot lidhur me zbërthimin e kohës së përdorur nga ekipet e Mbrojtjes për dëshmitarët e Prokurorisë.

Nuk e kisha shumë të qartë nëse do të merrnim sasi kohore më vete për t'u regjistruar kjo gjë, nëse është regjistruar, nëse keni mbajtur një regjistrim të tillë, do ta marrim nga Zyra Administrative?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të merrni këto shifra të pyetjeve pa përmendur nëse përmendet, pra, pyetjet pas pyetjeve të Gjykatësve.

Pra, vetëm blloku i parë i pyetjeve. Pra, nuk kemi shkuar përtej kësaj.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Mund të formulojmë ndonjë pyetje. Mund të bëjmë një, më falni, mund të formulojmë një kërkesë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kemi marrë kërkesën tuaj.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po a e keni kryer?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e kemi bërë akoma dhe nuk garantojmë nëse do ta bëjmë. Nuk mendojmë se është e domosdoshme nëse mund të përfshihen këto orë në vlerësimin që bëni ju për kohën tuaj për ne nuk vlen.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Vlen për ne, sepse duam që të kuptojmë se si shpenzohet koha brenda në sallë nëse kjo vjen nga pyetjet e Gjykatësve atëherë ne gjithë, sigurisht mund të argumentojmë se përse pyetjet e Gjykatësve po e zgjasin këtë gjykim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të shohim sigurisht për këtë. Mbetet për t'u parë, por në këtë pikë mund t'ju themi se nuk do t'i numërojmë, pra, pyetjet lidhur me kohën që i jepet.

Do të bëjmë ndërprerjen këtu të seancës deri më datë 18 mars në ora 09.00.

--- Seanca mbyllet në orën 15.24